

Organizata për siguri dhe bashkëpunim në Evropë MISIONI NË KOSOVË

Raporti 02/2006 i Shtyllës së III-të (OSBE) Mbi monitorimin e Kuvendit të Kosovës 11 mars 2006 – 7 prill 2006

Titujt kryesor

- PDK-ja dorëzon një interpelancë lidhur me gjendjen e rrugëve në Kosovë
- Kuvendi diskuton për bisedimet ndërmjet Prishtinës dhe Beogradit për decentralizimin
- Grupi parlamentar për Integrim ballafaqohet me vështirësi për t'u përfshirë në komisionet funksionale

1. Sfond

Raporti i dyzetekatërt i monitorimit është hartuar në përputhje me pikëpamjet referuese të Shtyllës së III-të të UNMIK-ut për themelimin e institucioneve (OSBE) dhe monitorimin e Kuvendit të Kosovës prej 26 nëntor 2002 dhe bazohet në pajtueshmërinë me Rregulloren e re të punës të miratuar në fund të seancës plenare më 20 maj 2005.

Gjatë periudhës raportuese, Kuvendi ka mbajtur tri seanca plenare, më 16 mars, 24 mars dhe më 6 prill si dhe katër mbledhje të rregullta të Kryesisë, më 14 mars, 21 mars, 24 mars¹ dhe më 30 mars. Të dhjetë komisionet, si dhe nënkomisioni për të drejtat e njeriut, barazi gjinore, peticione dhe ankesa publike, i kanë mbajtur mbledhjet gjatë kësaj periudhe.² Shtylla e III-të (OSBE) i ka monitoruar seancat plenare dhe mbledhjet e Kryesisë, si dhe 14 prej 20 mbledhjeve të komisioneve dhe një mbledhje të nënkomisionit.³

2. Vështrim

Seancën plenare të Kuvendit të Kosovës të mbajtur më 16 mars e kryesoi Kryetari i Kuvendit Kolë Berisha (LDK) dhe bashkëkryesoi anëtari i Kryesisë z. Mahir Yağcılar (6+/KDTP).

¹ Kryesia është takuar më 24 mars me shefat e grupeve parlamentare për ta planifikuar debatin për decentralizimin të caktuar për atë ditë. Shiko "Debatet".

² Komisioni për çështje gjyqësore, legjislativ dhe Kornizë Kushtetuese është takuar më 13 dhe 27 mars dhe 5 prill derisa Komisioni për shërbime publike, administratë lokale dhe media është takuar më 20 mars. Komisioni për buxhet dhe financa është takuar më 14 dhe 27 mars, dhe 5 prill derisa komisioni për të drejtat dhe interesat e komuniteteve është takuar më 31 mars. Komisioni për shëndetësi, punë, mirëqenie sociale dhe persona të zhdukur është takuar më 22 dhe 30 mars derisa Komisioni për arsim, shkencë, teknologji, kulturë, rini dhe sport është takuar më 22 dhe 23 mars. Komisioni për bashkëpunim ndërkombëtar dhe integritet euroatlantike është takuar më 20 mars derisa Komisioni për gatishmëri emergjente është takuar më 15 mars dhe 4 prill. Komisioni për bujqësi, pylltari, zhvillim rural, ambient dhe planifikim hapësinor është takuar më 21 mars derisa Komisioni për ekonomi, tregti, industri, energji, transport dhe telekomunikacion është takuar më 21 dhe 28 mars. Nënkomisioni për të drejtat e njeriut, barazi gjinore dhe peticione e ankesa publike është takuar më 15 dhe 30 mars.

³ Komisioni për çështje gjyqësore, legjislativ dhe Kornizë Kushtetuese më 27 mars dhe 5 prill; Komisioni për buxhet dhe financa më 27 mars dhe 5 prill; Komisioni për të drejtat dhe interesat e komuniteteve dhe kthim më 31 mars; Komisioni për shëndetësi, punë, mirëqenie sociale dhe persona të zhdukur më 22 dhe 30 mars; Komisioni për arsim, shkencë, teknologji, kulturë, rini dhe sport më 22 dhe 23 mars; Komisioni për bashkëpunim ndërkombëtar dhe integritet euroatlantike më 20 mars; Komisioni për gatishmëri emergjente më 4 prill; Komisioni për bujqësi, pylltari, zhvillim rural, ambient dhe planifikim hapësinor më 21 mars; Komisioni për ekonomi, tregti, industri, energji, transport dhe telekomunikacion më 28 mars; Nënkomisioni për të drejtat e njeriut, barazi gjinore dhe peticione e ankesa publike më 15 mars.

- Tetëdhjetë e tetë deputetë ishin të pranishëm në seancën plenare të 16 marsit.⁴
- Pikat kryesore të rendit të ditës të seancës plenare të 16 marsit:
 - Shqyrtimi i dytë i projektligjit për veprimtarinë botuese dhe librin (Projektligji është miratuar me 85 vota për dhe një votë kundër.⁵)
 - Shqyrtimi i dytë i projektligjit për konfliktet administrative (Projektligji është miratuar me 76 vota për dhe pa vota kundër.)
 - Shqyrtimi i parë i projektligjit për efikasitetin e energjisë (Projektligji është miratuar në parim me 45 vota për dhe 37 vota kundër.)
 - Shqyrtimi i parë i projektligjit për sigurinë në trafikun rrugor (Projektligji është miratuar në parim me 52 vota për dhe 18 vota kundër.)
 - Shqyrtimi i parë i projektligjit për parandalimin e pastrimit të parave (Projektligji është miratuar në parim me 69 vota për dhe një votë kundër.)
 - Shqyrtimi i propozimit të grupit parlamentar ORA për zëvendësimin e anëtarëve të komisioneve (Propozimi është miratuar me 64 vota për dhe katër vota kundër.)
 - Shqyrtimi i rekomandimeve të Komisionit për çështje gjyqësore, legislative dhe Kornizë Kushtetuese lidhur me emërimin e anëtarëve të Këshillit Gjyqësor të Kosovës (Rekomandimet janë miratuar me 36 vota për dhe 29 vota kundër.)
 - Propozimi i rendit të ditës për seancën plenare më 24 mars 2006

Seancën plenare të Kuvendit të Kosovës të mbajtur më 24 mars e kryesoi Kryetari i Kuvendit Kolë Berisha (LDK) dhe bashkëkryesoi anëtari i Kryesisë z. Sabri Hamiti (LDK).

- Tetëdhjetë e nëntë deputetë ishin të pranishëm në seancën plenare të 24 marsit.
- Pikat kryesore të rendit të ditës të seancës plenare të 24 marsit:
 - Raportimi i Grupit Negociator lidhur me bisedimet për decentralizimin në Vjenë (Zëvendëskryeministri Lutfi Haziri (LDK) ka bërë prezantimin në Kuvend pas të cilit ka pasuar debati dhe përgjigjet nga zëvendëskryeministri.)

Seancën plenare të Kuvendit të Kosovës të mbajtur më 6 prill e kryesoi Kryetari i Kuvendit Kolë Berisha (LDK) dhe bashkëkryesoi anëtari i Kryesisë z. Xhavit Haliti (PDK).

- Tetëdhjetë e tre deputetë ishin të pranishëm në seancën plenare të 6 prillit.
- Pikat kryesore të rendit të ditës të seancës plenare të 6 prillit:
 - Shqyrtimi i dytë i projektligjit për inspektoratin e produkteve të ndërtimit (Projektligji është miratuar me 72 vota për dhe një votë kundër.)
 - Shqyrtimi i dytë i projektligjit për institucionet e kulturës (Projektligji është miratuar me 63 vota për dhe një votë kundër.)
 - Shqyrtimi i dytë i projektligjit për mbrojtjen nga zjarri (Projektligji është miratuar me 69 vota për dhe një votë kundër.)
 - Shqyrtimi i parë i projektligjit për kodin e mirësjelljes së shërbyesve civil (Kuvendi ka votuar për *kthimin e projektligjit në Qeveri*, me 15 vota për projektligjin dhe 49 vota kundër tij.)
 - Shqyrtimi i parë i projektligjit për ndërprerjen e shtatzënisë (Projektligji është miratuar në parim me 59 vota për dhe pesë vota kundër.)
 - Shqyrtimi i propozimit të grupit parlamentar të LDK-së për zëvendësimin e anëtarëve në komisione.

⁴ Kjo ishte shifra e dhënë nga Kryetari i Kuvendit ose Kryesuesi në fillim të asaj dite, përveç nëse në këtë raport është bërë e ditur në ndonjë mënyrë tjetër.

⁵ Përveç nëse është bërë e ditur në ndonjë mënyrë tjetër, numri i abstenimeve nuk ishte shpallur. Që kur pajisja elektronike për votim ka filluar të përdoret, i tërë rezultati i votimit paraqitet në ekranin në ballë të sallës plenare, por numrat nuk janë të dukshëm nga galeria e vëzhguesve në pjesën e pasme të sallës.

- (Propozimi është miratuar me shumicë votash për, pa vota kundër dhe pa abstenime.)
- Shqyrtimi i propozimit të grupit parlamentar të LDK-së për zëvendësimin e z. Fatmir Sejdiu me z. Sabri Hamiti në komisionin ad-hoc për media
(Propozimi është miratuar me shumicë votash për, pa vota kundër dhe pa abstenime.)
- Propozimi i rendit të ditës për seancën plenare të 13 prillit

3. Punimet dhe praktikat parlamentare në seancat e Kuvendit

Rendi i ditës

Në fund të seancës plenare të 16 marsit Kryetari i Kuvendit e paraqiti rendin e ditës për seancën plenare të 24 marsit për miratim në Kuvend. Në fillim të seancës plenare më 6 prill Kryetari i Kuvendit kërkoi falje për faktin që rendi i ditës i seancës plenare në fjalë nuk ka mundur të votohet më herët prandaj, e ftoi Kuvendin ta votonte atë ditë. Një numër deputetësh bënë deklaratë lidhur me punën e Kuvendit ose të Qeverisë por Kryetari i Kuvendit konkludoi se vetëm njëra nga ato deklaratë përbënte çështje të ngutshme për shqyrtim të menjëhershëm nga Kuvendi, e ky ishte propozimi i znj. Teuta Hadri (PDK) për t'i diskutuar ethet hemorragjike. Propozimi i znj. Hadri është miratuar me 45 vota për dhe 29 vota kundër, andaj i është shtuar rendit të ditës së seancës në fjalë si pikë e fundit. Rendi i ditës i seancës plenare të 13 prillit (që më vonë është shtyrë për 20 prill) është paraqitur për miratim në fund të seancës plenare të 6 prillit.

Paraqitja dhe miratimi i rendit të ditës gjatë seancës paraprake është në pajtim me rregullën 23.1 që parasheh se “Në fund të çdo seance, Kryetari i Kuvendit, ose një anëtar tjetër i Kryesisë, propozon rendin e ditës të seancës së ardhshme” për miratim nga Kuvendi.

Përfshirja e çështjes së ngutshme në rendin e ditës është në pajtim me rregullën 29.1 e cila parasheh se “Në çdo seancë plenare, deputeti në marrëveshje me kryetarin e Kuvendit, mund të propozojë që Kuvendi të shqyrtojë menjëherë një çështje urgjente. Nëse Kryetari i Kuvendit konsideron se çështja menjëherë meriton t'i kushtohet vëmendja e Kuvendit, deputetit në fjalë i mundëson të japë propozime në Kuvend që pastaj do ta vënë në votim. Nëse Kuvendi vendos ta marrë çështjen parasysht, atëherë duhet ta bëjë në atë seancë, ndërsa orari dhe radhitja e kësaj pike rregullohet në përputhje me rrethanat e krijuara.”

Shpërndarja e dokumentave

- Projektligji për efikasitetin e energjisë ishte shpërndarë më 27 janar 2006; projektligji për sigurinë në komunikacionin rrugor ishte shpërndarë më 3 shkurt; dhe projektligji për parandalimin e pastrimit të parave ishte shpërndarë më 14 shkurt. Andaj, projektligjet janë shpërndarë 33, 28, përkatësisht 21 ditë pune para shqyrtimit të tyre të parë në seancën plenare më 16 mars 2006. Projektligji për kodin e mirësjelljes së nëpunësve civil ishte shpërndarë më 24 shkurt, dhe projektligji për ndërprerjen e shtatzënisë ishte shpërndarë më 20 mars. Andaj, projektligjet janë shpërndarë 28 përkatësisht dymbëdhjetë ditë pune para shqyrtimit të tyre të parë të caktuar për seancën plenare të 6 prillit.

Rregulla 35.1, parasheh që shqyrtimi i parë i projektligjve të bëhet jo më parë se dhjetë ditë pune dhe as më shumë se tri javë pune nga dita e shpërndarjes së tij. Shumica e projektligjeve gjatë kësaj periudhe raportuese janë shqyrtuar për të parën herë pas më shumë se tri javësh që nga data e shpërndarjes së tyre. Kuvendi edhe më tej vazhdon të ketë disa vështirësi në shqyrtimin e projektligjeve në pajtim me afatin e përcaktuar në rregulloren e punës edhe përkundër faktit se ka filluar t'i mbajë seancat plenare më shpesh. Sidoqoftë, disa nga seancat plenare i kushtohen vetëm diskutimit të çështjeve aktuale të rëndësishme e jo shqyrtimit të projektligjeve.

Debatet

- Më 24 mars, para se të fillonte seanca plenare, Kryesia është takuar me shefat e grupeve parlamentare për ta planifikuar debatin për decentralizimin i cili ishte caktuar për atë ditë. Pas

diskutimit të opcioneve të ndryshme, është arritur një marrëveshje e përgjithshme që secili grup parlamentar ta kufizonte numrin e folësve të tyre prej një deri në tre, varësisht nga madhësia e grupit parlamentar dhe interesimit për të debatuar për këtë çështje. Poashtu, është arritur marrëveshja që z. Emrush Xhemajli (LPK)⁶ t'i iplej fjala gjatë debatit meqë ai i pari kishte kërkuar debat lidhur me bisedimet për decentralizimin.⁷ Me rastin e hapjes së seancës plenare atë ditë Kryetari i Kuvendit i informoi deputetët se, në pajtim me rregullën 6.2, Kryesia kishte arritur marrëveshje në mes shefave të grupeve parlamentare lidhur me formën dhe zgjatjen e debatit, dhe e pyeti Kuvendin nëse mund të arrihej marrëveshje në seancë për t'i kufizuar diskutimet e deputetëve në më pak se dhjetë minuta. Z. Emrush Xhemajli deklaroi se ai ishte kundër shkurtimit të kohës për diskutim kështu që Kryetari i Kuvendit nuk e vëri në votim propozimin e tij dhe e informoi Kuvendin se koha e deklaratave mbetej dhjetë minuta.

Edhe pse ishte arritur marrëveshja në mes të Kryesisë dhe shefave të grupeve parlamentare për kufizimin e numrit të folësve nga secili grup në tre ose më pak, së paku tre deputetë folën nga secili grup parlamentar, ndërsa nga grupet parlamentare më të mëdha folën pesë, përkatësisht nëntë deputetë. Kah fundi i debatit z. Xhavit Haliti (PDK) e hapi deklaratën e tij duke thënë se ai nuk kishte pasur qëllimin të flasë, sepse kishte pritur nga grupet parlamentare që t'i përmbaheshin kufizimit për të cilin kishin arritur marrëveshje, por se kishte parë se deputetët dëshironin të vazhdonin debatimin.

Takimi i Kryesisë me shefat e grupeve parlamentare për ta planifikuar debatin e radhës paraqet përmirësim për dallim nga periudhat e mëparshme raportuese, kur kishte pak ose aspak konsultim në mes të Kryesisë dhe shefave të grupeve parlamentare. Konsultimi i rregullt me shefat e grupeve parlamentare parashihet në rregullën 6.2 dhe rregullën 23.3.⁸ Sipas rregullës 22.7, "diskutimi në Kuvend nuk zgjat më shumë se dhjetë (10) minuta për secilin deputet të Kuvendit...nëse Kuvendi nuk vendos ndryshe." Me kërkesë të deputetit i cili i pari e kishte propozuar debatin për bisedimet mbi decentralizimin, Kryetari i Kuvendit vendosi të mos e ftonte Kuvendin të deklarohej për shkurtimin e kohës së diskutimeve të deputetëve. Kohëzgjatja e përgjithshme e debatit ishte më e gjatë se sa ishte planifikuar fillimisht, sepse më shumë deputetë se sa ishte planifikuar ishin lejuar të flisnin gjatë debatit, por nuk ka pasur vërejtje të dukshme në Kuvend.

Procesi i votimit

- Kishte kuorum për të gjitha votimet në seancat plenare në fjalë.
Kjo është në pajtim me nenin 9.1.32 të Kornizës Kushtetuese dhe rregullën 31.1, e cila parasheh që për marrjen e vendimeve duhet të jenë të pranishëm shumica e deputetëve.

Përfaqësimi i Qeverisë në seancat plenare

- Kryeministri dhe shumica e ministrave ishin të pranishëm në fillim të seancës plenare të 16 marsit por u larguan pas përafërsisht 45 minutash para se Kuvendi të fillonte diskutimin e projektligjeve. Kryetari i Kuvendit i shpjegoi Kuvendit se kishte një mbledhje të Qeverisë të planifikuar tashmë, por Qeveria do të përfaqësohej nga zëvendësministrat në vend të ministrave. Gjatë shqyrtimit të dytë të projektligjit për konfliktet administrative z. Hydajet Hyseni (PDK) komentoi se më mirë do të ishte që të shtyhej miratimi përfundimtar i projektligjeve deri atëherë kur ministrat të mund të jenë të pranishëm në seancë plenare. Kryetari i Kuvendit u përgjigj se Qeveria ishte duke mbajtur mbledhje pikërisht në atë kohë, por se zëvendësministrat ishin të pranishëm në seancë dhe se ata mund ta përfaqësojnë Qeverinë sipas rregullores. Z. Hyseni komentoi se prania e zëvendësministrave nuk ishte e dukshme meqë ata ishin të ulur në pjesën e

⁶ Z. Xhemajli nuk është anëtar i asnjë grupi parlamentar në Kuvend.

⁷ Shiko raportin 01/2006 të shtyllës III (OSBE) mbi monitorimin e Kuvendit të Kosovës.

⁸ Rregulla 6.2: "Kryesia është përgjegjëse për programin e punës të Kuvendit. Ajo rishikon dhe përgatit rendin e ditës të mbledhjes së radhës të Kuvendit dhe merr pëlqimin nga grupet parlamentare për formën dhe për kohëzgjatjen e diskutimit për një çështje të caktuar të punës." Rregulla 23.3: "Kryesia konsultohet me kryetarët e grupeve parlamentare për caktimin e rendit të ditës të seancave të Kuvendit."

pasme të sallës plenare, e jo në vendet e ministrave, dhe pohoi se prioritet i ministrit do të duhej të ishte përcjellja e diskutimit të projektligjeve të fushës së tij/saj në Kuvend.

Asnjë dispozitë në rregulloren e punës së Kuvendit nuk e përmend rolin e zëvendësministrave, përkatësisht as nuk lejohet e as nuk ndalohet pjesëmarrja e tyre në seanca plenare. Në mungesë të çfarëdo akti ligjor të Kuvendit, kjo çështje rregullohet vetëm me rregullore të punës së Qeverisë. Neni 77.2 i rregullores të punës së Qeverisë parasheh që “Në rast të mungesës së ministrit që ka për të prezentuar një projektligj atë e zëvendëson zëvendësministri e në mungesë të këtij të dytit, Kryeministri, Zëvendëskryeministri ose një ministër tjetër i caktuar nga Kryeministri.” Do të ishte më e preferueshme që në të ardhmen seancat plenare të planifikohen ashtuqë të mos përkohjë me mbledhjet e Qeverisë.

Pyetjet për Qeverinë

- Në fillim të seancës plenare të 24 marsit, z. Hydajet Hyseni (PDK) komentoi se kishte pyetje që i ishin dorëzuar Qeverisë para disa muajsh e që akoma prisnin përgjigje, duke cituar posaçërisht një pyetje të tij që e kishte dorëzuar lidhur me personat e zhvendosur nga lugina e Preshevës. Ai tha se praktika parlamentare dhe Rregullorja e punës diktojnë se ministrat janë të obliguar t’u përgjigjen pyetjeve të deputetëve të Kuvendit sipas afateve të përcaktuara. Kryetari i Kuvendit u përgjigj se seanca plenare në zhvillim e sipër ishte seancë e posaçme me vetëm një pikë të rendit të ditës, por se procedura do të ndiqej në seancat tjera.

Z. Hyseni së pari e përmendi pyetjen që ka mbetur pa përgjigje në seancën e 15/16/19 dhjetorit, ku atëherë ai pat deklaruar se pyetjen e kishte dorëzuar tre muaj më parë.⁹ Sipas rregullave 26-27, pyetjet për Qeverinë për përgjigje gojore do të vendosen në rendin e ditës në njërën nga seancat e radhës menjëherë pasi të jetë dorëzuar pyetja, ndërsa pyetjet për Qeverinë për përgjigje me shkrim do të përgjigjen brenda dy javësh pas dorëzimit dhe “futen në procesverbalin e punimeve të Kuvendit për ditën kur është dhënë përgjigja ose për ditën e parë pas saj, kur Kuvendi mbledhet në seancë plenare.” Të njëjtat rregulla kërkojnë që pyetjet për Qeverinë që nuk marrin përgjigje me shkrim brenda afatit (rregulla 27) ose që refuzohen brenda Kuvendit për shkak se nuk janë në pajtim me rregulloren e Kuvendit (regulla 26.5) “të publikohen në buletin e Kuvendit.” Kur e ka ngritur z. Hyseni këtë çështje gjatë seancës plenare të 24 marsit, kishin kaluar për afërsisht gjashtë muaj pa përgjigje nga Qeveria. Buletini i Kuvendit të Kosovës nuk përmban pjesë për pyetjet që i janë dorëzuar Qeverisë.

Interpelanca

Më 14 mars, grupi parlamentar i PDK-së ka dorëzuar një interpelancë për ministrin e transportit dhe komunikacionit Qemajl Ahmeti (LDK) lidhur me mirëmbajtjen e rrugëve në Kosovë. PDK-ja në interpelancë kërkonte informacion të detajuar lidhur me gjendjen aktuale të rrugëve në Kosovë, puna që është bërë deri më tani, dhe projektet e planifikuara për vitin aktual fiskal. Kryesia e ka shqyrtuar interpelancën në mbledhjen e saj më 21 mars dhe është pajtuar pa diskutim që të njëjtën t’ia përcjellë Qeverisë.

Sipas rregullës 25 “propozimin për shqyrtimin e një çështjeje të caktuar lidhur me punën e Qeverisë ose të ministrive mund ta paraqesin jo më pak se dhjetë (10) deputetë . . . Interpelanca i parashtrohet Kryesisë së Kuvendit. Kryesia e Kuvendit, menjëherë sapo ta ketë marrë tekstin e interpelancës, ia dërgon Qeverisë, që është e detyruar ta shqyrtojë brenda jo më shumë se pesëmbëdhjetë (15) ditësh . . . Interpelanca vihet në rendin e ditës në afatin prej dhjetë (10) ditësh, pasi të merret përgjigja nga Qeveria. Në qoftë se Qeveria në afatin e paraparë me paragrafin 4 nuk e dërgon përgjigjen lidhur me interpelancën, interpelanca vihet si pikë e fundit në rendin e ditës të seancës plenare të Kuvendit që është duke u zhvilluar. Nëse Kuvendi nuk është për seancë, atëherë ajo vihet si pikë e parë në rendin e ditës së seancës së parë të radhës të

⁹ Shiko fusnotën 20 të raportit 10/2005 të Shtyllës së III-të (OSBE) mbi monitorimin e Kuvendit të Kosovës

Kuvendi. Kuvendi nuk mund ta refuzojë vënien e interpelancës për shqyrtim në rendin e ditës, përveç në rast se ajo nuk i plotëson kushtet formale sipas paragrafit 3 të kësaj rregulle.”¹⁰

Përfaqësimi i grupeve parlamentare në komisione

- Kah fundi i seancës plenare të 6 prillit, kur Kuvendi po shqyrtonte rendin e ditës së seancës së ardhshme plenare, z. Ferid Agani (Grupi për Integrim/PD) propozoi që të përfshihej edhe diskutimi i kërkesës së grupit të tij parlamentar për t’u përfshirë në komisionet funksionale, të dorëzuar tashmë tri herë në Kryesi që nga formimi i grupit parlamentar katër muaj më parë. Z. Agani shtoi se Kryesia e kishte miratuar në parim kërkesën e grupit për integrim në mbledhje të mëparshme por akoma nuk kishte gjetur mënyrë për zbatimin e saj. Ai e informoi Kuvendin se grupi i tij parlamentar e kishte dorëzuar një propozim për rritjen e numrit të anëtarëve në secilin komision funksional¹¹ prej dymbëdhjetë në trembëdhjetë, duke shtuar nga një anëtar të Grupit për Integrim, me ç’rast koalicioni qeverisës prapë do ta kishte shumicën – shtatë nga 13 vende. Kryetari i Kuvendit u përgjigj se Kryesia e kishte debatuar kërkesën gjerësisht, por nuk ka mundur të arrijë marrëveshje për miratimin e kërkesës meqë ishte shumë e vështirë të bëhej kjo “pa e prishur balancin” nëpër komisione. Z. Agani u përgjigj se kjo ishte hera e parë që po dëgjonte se Kryesia e konsideronte të pamundshme miratimin e kërkesës së grupit të tij parlamentar. Ai pohoi se propozimi për zgjerimin e komisioneve funksionale për një anëtar nuk do të ndikonte në balancin e pushtetit në komisione dhe kërkoi edhe një herë që grupi i tij parlamentar të përfshihej në komisionet funksionale në mënyrë që të mund t’i ipte “kontributin maksimal” funksionimit demokratik të Kuvendit. Z. Nazim Jashari (ORA) e përsëriti pohimin e mëhershëm të z. Agani se propozimi për zgjerimin e komisioneve funksionale për një anëtar nuk do ta prishte balancin politik, meqë do të kishte pesë anëtarë të LDK-së, një anëtar të AAK-së, dhe një anëtar të Grupit 6+, pra një numër i përgjithshëm i shtatë prej 13 vendeve do t’i takonin koalicionit qeverisës. Ai shtoi se sipas Rregullores së punës cilëtdo gjashtë deputet e kanë të drejtën të formojnë grup parlamentar dhe se të gjitha grupet parlamentare kanë të drejtën për pjesëmarrje të plotë – si deputetë, jo vetëm si vëzhgues – në komisionet e Kuvendit. Z. Jashari deklaroi se Kuvendi do të duhej t’i respektonte këto dy parime themelore dhe ta përfshinte Grupin për Integrim në komisionet funksionale. Z. Sabri Hamiti (LDK) pohoi se nga gjashtë anëtarë të Grupit për Integrim vetëm një – z. Gjergj Dedaj – nuk ishte anëtar i asnjë komisioni funksional dhe do të duhej t’i mundësohej anëtarësimi në komision. Z. Hamiti shtoi se LDK-ja dhe PDK-ja po e respektonin rregullën se secili deputet i Kuvendit duhet të shërbejë vetëm në një komision, por se anëtarët e grupeve më të vogla parlamentare shërbenin në dy ose edhe tri komisione. Kryetari i Kuvendit e mbylli diskutimin duke deklaruar se kishte pasur një propozim në Kryesi që Grupi për Integrim dhe Grupi 6+ të arrijnë marrëveshje për t’i ndarë në mes tyre vendet në komisione të cilat fillimisht i ishin ndarë grupit 6+, ose që deputetët e Grupit për Integrim ta kenë statusin e vëzhguesit në komisionet e Kuvendit.

Rregulla 48.4, e cila është cituar gjatë diskutimit në seancë plenare parasheh që si parim i përgjithshëm deputetët e Kuvendit duhet të shërbejnë në vetëm një komision, mirëpo nuk ua ndalon rreptësisht deputetëve që të shërbejnë në më shumë se një komision. Në dhjetor të vitit 2004, menjëherë pas konstituimit të këtij Kuvendi, Kryesia dhe grupet parlamentare kishin arritur një marrëveshje që grupet parlamentare të përfaqësohen në të gjitha komisionet funksionale si vijon: pesë deputetë të LDK-së, tre të PDK-së, dhe nga një prej AAK-së, SLKM-së, ORA-s dhe Grupit 6+. Propozimi ishte miratuar formalisht nga Kuvendi pas pak kohe. Sipas kësaj ndarjeje të vendeve nëpër komisione me të cilën janë pajtuar të gjitha grupet parlamentare ishte e qartë se disa deputetë të grupeve më të vogla parlamentare do të duhej të shërbenin në më shumë se një komision.

¹⁰ Rregulla 25.3 parasheh se interpelanca bëhet me shkrim dhe përfshin: “formulimin e saktë të çështjes që është lëndë e interpelancës, konkluzionin që propozohet dhe arsyetimin, emrin dhe mbiemrin e deputetit, që e ka parashtruar interpelancën në Kuvend, dhe nënshkrimet e deputetëve, që e mbështesin interpelancën.”

¹¹ Përbërja e Komisionit për të drejtat dhe interesat e komuniteteve dhe numri i anëtarëve në komisionin për buxhet rregullohen me Kornizë Kushtetuese andaj nuk janë propozuar ndryshime në këto komisione.

Pohimi se Grupi për Integrim tashmë mban disa vende në komisione nuk bën dallim në mes të Komisionit për të drejtat dhe interesat e komuniteteve dhe komisioneve funksionale të Kuvendit. Aktualisht, katër deputetë të Grupit për Integrim janë anëtarë të një komisioni të Kuvendit – të komisionit për të drejtat dhe interesat e komuniteteve. Përbërja e komisionit për të drejtat dhe interesat e komuniteteve përcaktohet nga Korniza Kushtetuese dhe bazohet në komunitetin etnik e jo në përkatësinë politike. Për më tepër, mandati parësor i komisionit është të shqyrtojë projektligjet dhe punën e Qeverisë nga aspekti i implikimeve në komunitetet etnike. Asnjëri nga deputetët e Grupit për Integrim nuk i takojnë ndonjërit prej komisioneve funksionale të Kuvendit¹², edhe pse Korniza Kushtetuese kërkon që “anëtarësia e të gjitha komisioneve funksionale reflekton shumëllojshmërinë e deputetëve të Kuvendit.” Përfaqësuesve të Grupit për Integrim duhet t’u mundësohet anëtarësimi i plotë në komisionet funksionale të Kuvendit, në pajtim me Kornizën Kushtetuese.

4. Qasja dhe pjesëmarrja e barabartë e komuniteteve

- Gjatë shqyrtimit të parë të projektligjit për efikasitetin e energjisë në seancën plenare të 16 marsit, z. Dzezair Murati (6+/Vakat) bëri vërejtjen se përfaqësuesit e komuniteteve minoritare nuk janë përfshirë në grupin punues që e ka hartuar projektligjin, dhe theksoi se mungesa e përfaqësimit të komuniteteve është problem më i gjerë që i atribuohet shumë grupeve të cilat hartojnë projektligje.

Vërejtje të ngjashme janë bërë në disa raste në Kuvend.¹³ Më 8 prill 2005, Kryeministri ka nxjerrë një “Vendim për përfshirjen e ekspertëve në grupet punuese për hartimin dhe vlerësimin e projektligjeve,” i cili parasheh që sekretari i përhershëm i Zyrës së Kryeministrit duhet t’i përfshijë përfaqësuesit e komuniteteve minoritare në grupet punuese për hartimin e projektligjeve që janë “të rëndësishme për minoritetet kombëtare apo interesat e tyre” por nuk është e qartë nga teksti se mbi çfarë baze përcaktohet se cilat projektligje janë të rëndësishme për interesat e komuniteteve.¹⁴

5. Qasja

Gjatë periudhës raportuese, Shtylla e III-të (OSBE) ka pasur qasje në seancat plenare, në mbledhjet e rregullta të Kryesisë, si dhe në të gjitha komisionet. Shtylla e III-të (OSBE) gjithashtu ka pranuar kopjet e dokumentave të shqyrtuara nga Kuvendi si dhe transkriptin e seancave të kaluara.

6. Transparenca

Radio Televizioni i Kosovës (RTK) ka siguruar transmetimin e drejtpërdrejtë të seancave plenare në fjalë. Publikut dhe monitoruesve institucional iu është mundësuar hyrja në seancat plenare. Kuvendi ka web faqen (www.kuvendikosoves.org, www.skupstinakosova.org, www.assemblyofkosovo.org). që përmban detaje biografike të deputetëve të Kuvendit, informacione për strukturën dhe funksionimin e Kuvendit, kopje të ligjeve dhe rezolutave të miratuara nga Kuvendi, si dhe informacione të tjera në gjuhën shqipe, serbe dhe angleze.

FUND.

¹² AAK-ja i ka ofruar Partisë së Drejtësisë (PD) vendin e saj në Komisionin për bujqësi, pylltari, zhvillim rural, ambient dhe planifikim hapësinor, por z. Ferid Agani ka zgjedhur që të mos i bashkohet këtij komisioni duke shpresuar t’i bashkohet ndonjë komisioni më përkatës me fushën e tij të ekspertizës

¹³ Shiko raportet 02/2005 dhe 01/2005 të Shtyllës së III-të (OSBE) mbi monitorimin e Kuvendit të Kosovës.

¹⁴ Vendimi nr. 041/2005, 8 prill 2005.